



Në mbështetje të nenit 12, nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja (b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal të datës 13.03.2008, nenit 10 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 2.2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 23.09.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e buxhetit për vitin 2023

Neni 1

Komuna e Rahovecit konform dispozitave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, miraton buxhetin për vitin 2023 me limitet, në bazë të qarkores buxhetore 01 dhe 02 të shpërndara nëpër kategori ekonomike dhe buxheti për vitin 2023 është gjithsej 17,548,240.00€, ku nga nga grandet qeveritare janë 16,102,637.00€ dhe të hyrat vetanake janë 1,445,603.00€.

Shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike për Komunën e Rahovecit për vitin 2023 është si vijon:

Paga dhe Mëditje	8,503,088.00 €
Mallra dhe Shërbime	2,203,829.00 €
Shpenzimet Komunale	370,000.00 €
Subvencionet dhe Transferet	820,000.00 €
Investimet Kapitale	5,651,323.00 €
Buxheti total për vitin 2023	17,548,240.00 €

Neni 2

Të hyrat buxhetore komunale krijohen nga dy burime: Grandit qeveritar dhe të hyrave vetanake të cilat realizohen nga tarifat dhe ngarkesat e aprovuara në Kuvendin Komunal të Rahovecit.

Neni 3

Shpenzimet nënkuptojnë të gjitha shpenzimet që kryhen nga Buxheti komunal dhe Buxheti për Arsimit dhe Shëndetësi në Komunë, sipas rregullave dhe udhëzimeve financiare të mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Neni 4

Ky vendim do të aplikohet së zbatuari nga 1 Janari 2023.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr.373/22
Datë: 23.09.2022

